E paraqitura, qytetare italiane, për identitetin e të cilës, cilësinë dhe kompetencat e të cilës unë jam i sigurtë, merr kryesinë e Asamblesë, sipas nenit 13 të Statutit të shoqërisë dhe të nenit 2479-bis, paragrafi i katërt, i K.C. dhe konstaton duke pranuar që:

- kjo asamble është mbledhur pa thirrje formale, në formë të plotë;
- që shoqëria "ELEKTRA S.R.L." me ortak të vetëm është e vetmja ortake me të drejta mbi kuotat e pjesëmarrjes në kapitalin e plotë të shoqërisë prej 220.000,00 Euro të



shoqërisë me një ortak “Scientia SRL”, sic rezulton në regjistrin kompetent të Ndërmarrjeve.

- që ky procesverbal do të transkriptohet në librin e mbledhjeve dhe asambleve;
- që Organi Administrativ është i pranishëm në shoqërinë Administruese të vetme “ELEKTRA S.R.L.” me ortak të vetëm, në vendin e përfaqësuesit të saj ligjor, sic është formuar si më lart;
- që nuk ekziston organi i kontrollit.

Kryetarja deklaron këtë Asamble vlefshmërisht të themeluar në formë të përgjithshme dhe vendos mbi sa më poshtë vijon:

Rendi i ditës

- Krijimi i selisë dytësore të shoqërisë në Shqipëri dhe ndryshimi i nenit 2 të marrëveshjeve të shoqërisë.
 - Mbi argumentin e vetëm të rendit të ditës merr fjalën e paraqitura, e cila evidenton se si është e nevojshme për shoqërinë dhe zhvillimit dimensional të saj, të krijojë në Shqipëri, në qytetin e Tiranës, në Sheshi Skenderbej, pallat i Kulturës, 1000, pranë “Camera di Commercio Italiana in Albania”, një seli e re dytësore jashtë vendit, përveç asaj që ekziston në Maqedoninë e Veriut, me ndryshime të mëtejshme të nenit 2 të Statutit të shoqërisë.
- Ortakja e vetme, shoqërisë “Elektra srl” me ortak të vetëm, e përfaqësuar nga e paraqitura

VENDOS

- Të krijojë seli dytësore të shoqërisë, me përfaqësim të qëndrueshëm, në Shqipëri në qytetin e Tiranës, në Sheshi Skenderbej, Pallati i Kulturës, 1000, pranë “Camera di Commercio Italiana in Albania”,
- Të emërojë përfaqësues me prokurë në selinë dytësore, deri në revokim ose dorëheqje:
- **Ing. Mirco Paolini**, lindur në Corinaldo (AN) më datë 30 janar 1970, me banim në Forlì (FC) Corso della Repubblica n.186, kod fiskal PLN MRC 70A30 D007V, qytetar italian i cili emërohet në këtë akt.
- I paraqituri, për identitetin e të cilit unë Noteri jam i sigurtë, deklaron se pranon detyrën dhe në ngarkim të tij nuk ka çështje të paligjshmërisë apo humbje të parashikuara nga legjislacioni; ai delegon për këtë qëllim, mua Noterin për të kryer regjistrimin pranë Regjistrat kompetent të Ndërmarrjeve;
- për t'i dhënë personit përgjegjës për zyrën e degës dytësore kompetencat më të gjera të administrimit dhe përfaqësimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm dhe përfaqësimin e shoqërisë në zyra të tilla dytësore dhe kështu me të drejtën për të kryer, pa asnjë kufizim, të gjitha aktet dhe veprimet në lidhje me zyrën e dytësore, duke përfshirë mundësinë e blerjes, shitjes, hipotekimit dhe të zotërojë në përgjithësi për të gjitha pasuritë, si të luajtshme ashtu edhe të paluajtshme, si dhe emërimin e personave të tjerë përgjegjës dhe / ose përfaqësues me

prokurë për të njëjtën zyrë dytësore. I emëruari i përgjigjet organit administrativ; emërohet dhe revokohet me vendim të aksionarëve;

- të ndryshojë nenin 2 të Statutit të shoqërisë si më poshtë:

Neni 2 – Selia (teksti i ri)

Selia ligjore e shoqërisë është në Forli (FC), në adresën që rezulton nga regjistrimi i kryer pranë Regjistrit kompetent të Ndërmarrjeve.

Shoqëria ka seli dytësore në Republikën e Maqedonisë, në Shkup Via Giorgij Peshov 5, dhe seli dytësore sekondare në qytetin e Tiranës, në Sheshi Skenderbej, pallat i Kulturës, 1000, pranë “Camera di Commercio Italiana in Albania”;

- të përshtatë tekstin e ri të Statutit të Shoqërisë, të përditësuar me ndryshimet e vendimit, të cilën Kryetari më dorëzoi dhe, e ka nënshkruar në mënyrë të rregullt, në këtë procesverbal do të bashkëlidhet nën shkronjë “A”, duke hequr dore nga leximi pasi të paraqiturit heqin dorë;

- të delegojë tek e paraqitura Cristina Gamba, në cilësinë e saj të Administratores së vetme të shoqërisë "ELEKTRA S.R.L." me ortak i vetëm, të gjitha kompetencat më të gjera dhe të duhura për të miratuarkët procesverbal dhe shtojcat Marrëveshje e Shoqërisë bashkëlidhur shtesat e mundshme, anulimet dhe ndryshimet e natyrës formale që mund të jenë të nevojshme për regjistrimin në Regjistrin e Ndërmarrjeve, si edhe të procedojë për depozitimin pranë regjistrit kompetent të ndërmarrjeve kur është krijuar seli dytësore, me të gjithë dokumentacionin e duhur për plotësimet publicitare në vijim të hapjes së kësaj selie dytësore.

Duke mos patur gjë tjetër për të vendosur dhe asnjë nuk kërkojnë fjalën në Asamblë deklarohet e mbyllur në orën e nënshkrimit të këtij akti.,

Taksat dhe shpenzimet e këtij procesverbali dhe formalitete që rrjedhin prej saj janë në ngarkim të shoqërisë “Scientia SRL”, më ortak të vetëm që i merr përsipër.

Të paraqiturit më autorizojnë mua Noterit për trajtimin e të dhënave personale në përputhje me D.Legj. 196/2003 dhe ndryshimet dhe shtesat e tyre, si edhe në përputhje me Rregulloren (UE) 2016/679 të Parlamentit European dhe të Këshillit të datës 27 prill 2016, në lidhje me përmbushjet që janë të lidhura me këtë akt, si edhe të lëshojnë kopje të këtij aktit për Autoritetet që e kërkojnë.

Tatimi i pullës për këtë akt do të lëshohet sipas Dekretit Legjislativ datë 18 dhjetor 1997 nr. 463, kështu siç është ndryshuar nga Dekretit Legjislativ nr. 9 datë 18 janar 2000 dhe ndryshimet dhe shtesat e mëtejshme, nga D.M. i fundit datë 22/02/2007.

Unë noteri, mora dhe hartova këtë procesverbal i cili, i shkruar pjesërisht nga unë dhe pjesërisht nga person i besuar prej meje në një fletë të zënë nga tre faqe të plota dhe deri këtu faqja e katërt, pasi iu lexua të paraqiturve që deklarojnë se e miratojnë atë.

U nënshkrua në orën gjashtëmbëdhjetë dhe pesëdhjetë minuta.

Firmosur: Cristina Gamba - Mirco Paolini – Noter Marcello Porfiri



Shtojca A më nr. 6.210

STATUTI I SHOQËRISË

Kapitulli I

Emërtimi, Selia, Objekti dhe Kohëzgjatja

NENI 1) EMËRTIMI

Është themeluar shoqëria më përgjegjësi të kufizuar emërtuar “Scientia Srl.”.

NENI 2) – SELIA

Selia ligjore e shoqërisë është në Forli (FC), në adresën që rezulton nga regjistrimi i kryer pranë Regjistrat kompetent të Ndërmarrjeve.

Shoqëria ka seli dytësore në Republikën e Maqedonisë, në Shkup Via Giorgij Peshov 5, dhe seli dytësore sekondare në qytetin e Tiranës, në Sheshi Skenderbej, pallat i Kulturës, 1000, pranë “Camera di Commercio Italiana in Albania”;

NENI 3) – OBJEKTI I SHOQËRISË

Shoqëria ka për objekt aktivitet e mëposhtme:

Ofrimin e shërbimeve për zhvillimin e aktiviteteve teknike dhe shkencore në sektorin e ndërtimeve civile dhe industriale. Në fushën e sa më lartpërmendur shoqëria mund të ofrojë shërbime asistence në lidhje me menaxhimin e kontratave të sipërmarrjes; në projektimin, menaxhimin e punimeve, ndërtimin dhe kolaudimin të veprave dhe sistemeve të çdo natyre; në përgatitjen e sistemeve të cilësive të ndërmarrjes; në menaxhimin e projekteve të rikthimit dhe fakteve mjedisore;

Në financimin e projekteve, edhe të veprave të pa projektuara.

Shoqëria mund të ofrojë furnizim të shërbimeve energjetike, apo të masave të kursimit të energjisë dhe/apo përmirësimin e efikasitetit të energjisë dhe/ose instalimin e sistemeve nga burimet energjike të rinovueshme në instalimet apo në vende të klientëve me pagesë bazë, pjesërisht apo e kërkuar për përmirësimin e efikasitetit të energjisë së siguar dhe mbi arritjen e kriterëve të tjera të rendimenteve të përcaktuara.

Zhvillimi i aktivitetit të kërkimit në përgjithësi si edhe përgatitjen e kurseve dhe publikimeve për shpërndarjen dhe aplikimin e njohjeve shkencore, teknologjike, drejtuese dhe organizative të sektorëve të interesit të vetë.

Gjithashtu, shoqëria mund të kryejë punime ndërtimi dhe punime gjërmimi; punime të restaurimit; vepra të posaçme në beton arme; impiante teknologjike dhe të posaçme; ndërtime dhe shtrime të rrugëve ; punime hekurudhore dhe aeroportuale; punime hidraulike; punime detare dhe portuale; diga; galeri; sisteme për shpërndarjen dhe prodhimin e energjisë; struktura metalike.

Me qëllimin e vetëm të arritjes së objektit të shoqërisë dhe në mënyrë që ky aktivitet të mos jetë mbizotërues, shoqëria mund të ndërmarrë dhe japë agjenci, komisione, përfaqësi dhe mandate; si edhe të kryejë çfarëdolloj operacioni tregtar, financiar, pasuritë e luajtshme dhe te paluajtshme të dobishme apo të nevojshme, mjafton që të mos jete në drejtim të publikut. Gjithashtu shoqëria mund të ndërmarrë pjesëmarrje në shoqëri të tjera ose ente me qëllimin e thjeshtë të investimit dhe jo të grumbullimit dhe në përputhje me legjislacionin në këtë fushë. Është përjashtuar shprehimisht a aktiviteti i statutit lëshimi i garancive, si në interesin e shoqërive pjesëmarrëse por në favor të të tretëve, aty ku ky aktivitet nuk ka karakter dhe nuk është krijuar me rrugë ngushtësisht strumentale në arritjen e objektit të shoqërisë.

Gjithashtu përjashtohet nga objekti i shoqërisë edhe mbledhja e kursimeve midis publikut dhe blerja dhe shitja nëpërmjet ofertës ndaj publikut të strumenteve financiare të disiplinuar nga T.U.I.F. (D. Legj. Nr. 58 datë 24/02/1998), si edhe ushtrimi në drejtim të publikut të aktivitetit të marrjes së pjesëmarrjeve, të koncesioneve të financimeve nën çfarëdolloj forme, të ofrimit të shërbimeve të pagesës dhe ndërmjetësimit në këmbim dhe çdo lloj forme aktiviteti si në nenin 106 T.U.L.B. (D. Lgj Nr. 385 datë 1/9/1993) është gjithashtu i përjashtuar, më mënyrë të detyrueshme. Gjithashtu përjashtohet në mënyrë të detyrueshme çfarëdolloj aktiviteti që i rezervohet të regjistruarve në dhoma profesionale të parashikuara nga D. Legj. 58/98.

Me qëllim arritjen e qëllimit të objektit të shoqërisë, shoqëria mund të kryejë të gjitha operacionet e pasurive të luajtshme dhe te paluajtshme si dhe çdo aktiviteti tjetër që do të konsiderohet i nevojshme apo i dobishëm, të marrë hua dhe të marrë pjesë në çdo lloj kredie tjetër dhe/ose operacion i qirasë financiare.

Neni 4) Kohëzgjatja

Shoqëria ka kohëzgjatje deri në datën 31 (tridhjetë e një) dhjetor 2050 (dymijë e pesëdhjetë)

KAPITULLI II

KAPITALI, INSTRUMENTET E FIANCIMIT DHE PJESËMARRJE NË SHOQËRI

NENI 5) - KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali i shoqërisë është i barabartë me prej 220.000,00 Euro (dyqind e njëzet mijë presje zero zero).

NENI 6) – RRITJA E KAPITALIT

Shoqëria mund të rrisë kapitalin si nëpërmjet kontributeve të reja ashtu edhe nëpërmjet kalimit të rezervave të kapitalit. Rritja e kapitalit mund të ndodhë nëpërmjet kontributeve në para, në natyrë ose kredi, ose çfarëdolloj elementi të ndjeshëm të vlerësimit ekonomik.

Me përjashtim të rastit sipas nenit 2482 ter K.C., rritja e kapitalit mund të zbatohet nëpërmjet ofertës së kuotës së një lëshimi të ri tek të tretë; në këtë rast i takon ortakëve që nuk janë lejuar në vendimin e të drejtës së parablerjes. Në ___ të zvogëlimit të kapitalit për humbje, duhet të depozitohet pranë selisë së shoqërisë të paktën tetë ditë përpara asamblesë një raport paraprak i Organit Administrativ mbi situatën pasurore të shoqërisë dhe vërejtjet e kolegjit të ekspertëve kontabël ose e revizorit, nëse janë të emëruar, pa përjashtuar të drejtën e ortakëve për të marrë kopje të këtyre dokumenteve nga shoqëria.

Pjesëmarrjet e ortakëve mund të përcaktohen në masën jo proporcionale me kontributet.

NENI 7) – KONTRIBUTET DHE FINANCIMET E ORTAKËVE

Shoqëria mund të blejë nga ortakët, me pëlqim paraprak individual të tyre, pagesa në llogari kapitale ose fonde të pakthyeshme pa detyrim për të ripaguar ose të lidhë me ortakët, në bazë të negociatave të personalizuar, financime me detyrim rimbursimi, të cilat supozohet se nuk mbajnë interes, veç nëse në përfundim rezultojnë ndryshe nga një dokument i shkruar.

Rimbursimi i kontributeve dhe financimeve të ortakëve në favor të Shoqërisë, të kryera një kohë kur ekziston një çekuilibër i tepërt i borxhit në lidhje me pasuritë neto ose në një situatë financiare të Shoqërisë në të cilën do të ishte i arsyeshëm një kontribut, dhe është shtyrë në lidhje me kënaqësinë e kreditorëve të tjerë dhe, nëse është kryer në vitin paraprak të deklarimit të falimentimit të shoqërisë, ai duhet të kthehet. Shoqëria gjithashtu mund të marrë fonde nga ortakët në një të drejtë tjetër, gjithmonë me detyrim rimbursimi, në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi në lidhje me mbledhjen e kursimeve nga ortakët.

NENI 8) - TRANSFERIMI I PJESËMARRJEVE TË SHOQËRISË ME AKT MIDIS TË GJALLËVE

Pjesëmarrjet janë të transferueshme me akt midis të gjallëve sipas kushteve të mëposhtme.


Nëse një ortak synon të shesë të gjithë ose një pjesë të aksioneve të tij me akt midis të gjallëve, kundër pagesës, secili nga ortakëve i takon e drejta e parablerjes në barazi të çmimit dhe kushteve.

E drejta e parablerja nuk ushtrohet në rast të transferimit në shoqëri fiduciaria dhe në rast të lëshimit në të pjesëmarrjeve në emër tjetër nga ana e fiduciario tek fiduciante, pas një paraqitje paraprake të mandatit të besimit.

Transferimi nënkupton transferimin e pronës dhe çdo të drejtë tjetër për pjesëmarrje; në këtë rast e drejta e parablerjes ka për objekt blerjen e së njëjtës të drejtë që aksionari synon të transferojë.

Me qëllim të lejojë ushtrimin e të drejtës së parablerjes, transferuesi duhet të komunikojë kushtet e shitjes, çmimin dhe emrin e blerësit (denuntiatio) duke dërguar një letër rekomande me lajmërim marrje nga ortakët e tjerë.

I njëjti komunikim duhet t'i bëhet njëkohësisht, për qëllime informacioni, organit administrativ, me një letër rekomande me lajmërim marrje. Ortakët e tjerë duhet të shprehin gatishmërinë e tyre për të ushtruar të drejtën e parablerjes me një letër rekomande me



lajmërim marrje dërguar transferuesit brenda tridhjetë ditëve nga marrja e komunikimit të shitjes së këtij të fundit. I njëjti vullnet duhet të manifestohet, me qëllim të njoftojë organit administrativ, me letër rekomande me lajmërim marrje. E drejta e parablerjes ushtrohet për këtë të drejtë mbi pjesëmarrje e plotë ose pjesë e pjesëmarrjes që ortaku ka ndërmend të transferojë, i barabartë me çmimin dhe kushtet.

Nëse disa ortakë ushtrojnë të drejtën e parablerjes, të njëjtët mund të bëhen blerës të pjesëmarrjes që ofrohet për shitje në proporcion me pjesëmarrjen e secilës prej tyre.

Ortakët që nuk shprehin vullnetin për të blerë brenda afateve kohore dhe me respektimin e formaliteteve të përshkruara më lart, priren të heqin dorë nga ushtrimi i së drejtës së parablerjes; pra pjesëmarrja mund t'i shitet blerësit të treguar në njoftim ose ortakëve që kanë ushtruar të drejtën e parablerjes.

Transferimi duhet të bëhet brenda tre muajve nga përfundimi i afatit për ushtrimin e parablerjes, pas së cilës, nëse nuk është kryer transferimi, do të jetë e nevojshme të bëhet një njoftimi i ri.

Procedura e vendosur më lart për ushtrimin e të drejtës së parablerjes, nuk duhet të zbatohet kurdo që cdo ortak që ka të drejtën e dorëheqjes me shkrim të drejtës së parablerjes dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në aktin e transferimit të pjesëmarrjes.

NENI 9) TRANSFERIMI I PJESMARRJES SOCIALE PAS VDEKJES

Pjesëmarrjet e shoqërisë janë lisrisht të transferueshme pas vdekjes.

Në rast të një bashkëpronësia të një pjesëmarrjeje për efekt të transferimit pas vdekjes, të drjetat e bashkëpronarëve duhet të ushtrohen nga një përfaqësues i përmbashkët emëruar sipas mënyrave të parashikuara nga neni 1105 dhe 1106 k.c.

NENI 10) DORËHEQJA E ORTAKUT

Secili ortak ka të drejtë të tërhiqet nga shoqëria nëse nuk është dakort me ndryshimin e objektit ose llojit të shoqërisë, bashkimin ose shkrirjen e tij, revokimin e gjendjes së likuidimit, transferimin e selisë jashtë vendit, përfundimin e operacioneve që nënkupton një ndryshim thelbësor të objektit të shoqërisë ose një ndryshim të rëndësishëm të të drejtave që u janë dhënë ortakëve, sipas nenit 24 68 paragrafi i tretë dhe në raste të tjera të përcaktuara me ligj.

NENI 11) MËNYRAT E USHTRIMIT TË DORËHEQJES

Ortaku që ka ndërmend të tërhiqet nga shoqëria duhet të japë një komunikim te organit administrativ me anë të një letre të rekomande me L.M., dërguar brenda tridhjetë ditësh nga regjistrimi në Regjistrin e Ndërmarrjeve të vendimit që çoi në tërheqjen, ose nga transkriptimi i saj në librin e vendimeve të ortakëve, nëse nuk kërkohet regjistrimi. Ky transkriptim duhet të bëhet, nën kujdesin dhe përgjegjësinë e organit administrativ, brenda pesë ditëve nga data e vendimit.

Dorëheqja ka efekt në drejtim të shoqërisë nga momenti në të cilën kjo ka marrë deklaratën e mësipërme. Rimbursimi i pjesëmarrjeve të ortakëve që ushtrojnë të drejtën e dorëheqjes sipas këtij neni, do të bëhet sipas ligjit.



Pasi të jetë marrë deklarata me shkrim e tërheqjes, administratorët duhet të informojnë ortakët e tjerë pa vonesë duke caktuar një afat maksimal prej 30 (tridhjetë) ditësh për shprehjen e disponueshmërisë së tyre, me letër rekomande me L.M. dërguar shoqërisë, për të blerë tarifën e pjesëmarrjes së ortakut të dorëhequr në përputhje me artin. 2473 të Kodit Civil Italian, ose, ndoshta, për të identifikuar një blerës të tretë.

KAPITULLI III

Vendime të Ortakëve

NENI 12) VENDIMET E ORTAKËVE

Ortakët vendosin për argumentet që një ose më shumë administratorë ose më shumë ortakë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit të shoqërisë paraqesin për miratimin e tyre. Në çdo rast, i rezervohet kompetencës së ortakëve:

- 1) miratimi i pasqyrave financiare dhe shpërndarja e fitimeve;
- 2) emërimi i drejtorëve
- 3) emërimi, në rastet e parashikuara me ligj, të auditorëve ligjorë dhe kryetarit të bordit të auditorëve ose të auditorit;
- 4) ndryshimet në akt themelimin në bazë të nenit 2480 k.c.;
- 5) vendimi për të kryer operacione që sjellin ndryshime thelbësore i objektit të shoqërisë përcaktuar në nenin 3) ose një ndryshim i rëndësishëm në të drejtat e ortakëve.

Secili ortak ka të drejtë të marrë pjesë në vendimet e parashikuara në këtë nen dhe vota e tij është e vlefshme në përpjesëtim me pjesëmarrjen e tij. Vendimet e ortakëve mund të miratohen:

- a) me vendim të asamblesë;
- b) me konsultë me shkrim të ngritur nga secili nga administratorët dhe ortakët që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit të shoqërisë, për sa kohë që dokumentet e nënshkruara nga ortakët tregojnë qartë çështjen e vendimit dhe konsensusin për të. Vendimet në lidhje me ndryshimin e aktit të themelimit ose me përfundimin e operacioneve që përfshijnë një ndryshim thelbësor në objektin e shoqërisë ose të drejtat e ortakëve duhet të miratohet në çdo rast me vendim të asamblesë.

Është gjithmonë e nevojshme pajtueshmëria me metodën kolegjiale nëse bëhet një kërkesë nga një ose më shumë administratorë, ose nga shumë ortakë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit të shoqërisë.

Në rast se vendimi miratohet me konsultë me shkrim, teksti i shkruar i të njëjtit, nga i cili rezulton qartë tema e lidhur, dhe përgatitur nga një ose më shumë administratorë ose nga shumë ortakë që përfaqësojnë të paktën një të tretën e kapitalit të shoqërisë. I paraqitet secilit ortak, një komunikimi përmes:

- me letër rekomande ose telegram të dërguar ortakëve në banesën e tyre që rezultojnë në librin e ortakëve ose;
- telegfaks ose mesazh në postë elektronike dërguar ortakëve përkatësisht në numrin e faksit ose në adresën e postës elektronike të njoftuar shqiptarëve he të mbajtur shënim në librin e ortakëve.

Komunikimi gjithashtu do të konsiderohet se është bërë nëse teksti i vendimit është i datuar dhe nënshkruar nga ortaku i thirrur.

Ortaku i thirrur, nëse e konsideron, jep pëlqimin e tij me shkrim, duke nënshkruar tekstin e përgatitur ose duke e miratuar atë me shkrim.

Vendimi përfundohet në mënyrë të vlefshme kur të gjithë ortakët janë konsultuar dhe shumica e caktuar ka shprehur dhe komunikuar kompanisë pëlqimin e tyre për vendimin e propozuar.

Vendimi i ortakëve merret me votimin e favorshëm të shumë ortakëve që përfaqësojnë pjesën më të madhe të kapitalit të shoqërisë.

Dokumentacioni në lidhje me konsultën me shkrim duhet të mbahet midis dokumenteve të shoqërisë dhe vendimeve (edhe nëse janë negative) të transkriptuara pa vonesë nga administratorët në librin e vendimeve të ortakëve. Administratorët duhet të informojnë auditorët pa vonesë për vendimet e marra.

NENI 13) ASAMBLEA E ORTAKËVE

Asambleja mund të mbahet në zyrën e regjistruar ose diku tjetër, për aq kohë sa është në territorin italian. Thirrja e asamblesë bëhet:


- me letër rekomande ose telegram të dërguar ortakëve tetë ditë përpara në adresën që rezultojnë në Librin e ortakëve;
- ose me faks ose postë rekomande dërguar ose dorëzuar ortakëve të paktën pesë ditë përpara mbledhjes;

si në këtë rast të fundit, dërgimi duhet të kryhet me tefaks që rezultojnë nga libri i ortakëve; në mungesë të këtij rezultati mbledhja nuk mund të kryhet me faks.

Në rastin e administratës të besuar dy ose më shumë administratorëve me firmë veçmas ose të përbashkët, në përputhje me paragrafin e tretë të neni 2475 të kodit civil, mbledhja do të kryhet nga administratori më i vjetër në moshë. Kopja e komunikimit dorëzuar dorazi, i nënshkruar nga marrësi, si dhe dëftesat ose elementët e tjerë që vërtetojnë marrjen e komunikimeve me faks duhet të mbahen nga shoqëria.

Pjesëmarrja në asamble mund të bëhet edhe me mjete telekomunikimi, me kusht që të mund të identifikohen të gjithë pjesëmarrësit dhe të lejohen që të ndjekin diskutimin, të marrin, transmetojnë ose vëzhgojnë dokumente, të marrin pjesë verbalisht dhe në kohë reale mbi të gjitha argumentet.

Ortaku mund të përfaqësohet në mbledhje dhe dokumentacionin përkatës dhe të mbahet nga shoqëria.



Asambleja vendos me votë të favorshme të shumë ortakëve që përfaqësojnë shumicën më të madhe të shoqërisë dhe, në rastet e parashikuara nga numrat 4) dhe 5) të nenit 12 të kësaj marrëveshje, me votimin e favorshëm të anëtarëve që përfaqësojnë 2 / 3 (dy të tretat) e kapitalit të shoqërisë.

Asambleja kryesohet nga administratori i vetëm ose nga kryetari i këshillit të administratorëve ose të administratorit më të vjetër ose, në mungesë, nga personi i caktuar nga personat në fjalë. Kryetari i asamblesë verifikon rregullsinë e themelimit, verifikon identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, rregullon zhvillimin e tij dhe konstaton rezultatet e votimeve; rezultatet e këtyre vlerësimeve duhet të regjistrohen në procesverbalin e nënshkruar nga kryetari dhe, ndoshta, nga noteri.

Procesverbali duhet të hartohet pa vonesë nga personi përgjegjës, ose në rastet e parashikuara me ligj ose të përcaktuara nga administratorët, nga noteri.

Në mungesë të një thirrje zyrtare, asambleja konsiderohet se thirret rregullisht kur e gjithë shoqëria merr pjesë në të dhe të gjithë administratorët dhe auditorët ose revizorët, nëse janë emëruar, janë të pranishëm ose informohen për mbledhjen dhe mund të vendosin kur asnjë nga pjesëmarrësit nuk kundërshton diskutimin e temës. Nëse administratorët, auditorët ose revizori, nëse janë emëruar, nuk janë të pranishëm, kryetari i mbledhjes duhet të përfshijë në procesverbal që administratorët, auditorët ose revizorët janë informuar për mbledhjen.

KAPITULLI IV

ADMINISTRIMI DHE KONTROLLI

NENI 14) ADMINISTRIMI

Administratorët janë të pajisur me të gjitha kompetencat e drejtimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të shoqërisë për zbatimin e objektit të shoqërisë, përveç kompetencës që i atribuohet vendimit të aksionarëve në përputhje me ligjin dhe nenin 12) të këtij statuti. Emërimi i administratorëve i rezervohet kompetencës së ortakëve.

Administratorët të cilët mund të jenë ortakë ose jo ortakë, qëndrojnë në detyrë për një periudhë të pacaktuar, përveç nëse përcaktohet një afat në kohën e emërimit.

Nëse për ndonjë arsye mungon një ose më shumë këshilltarë, do të veprohet sipas nenit 2385 dhe 2386 e k.c. Shoqëria do të drejtohet nga një administrator i vetëm ose nga një shumicë e administratorëve nga dy deri në pesë anëtarë sipas aktit të emërimit.

Nëse administrimi i është besuar më shumë se një personi, ortakët, me vendimin për emërimin, do të vendosin nëse është përgjegjësia e tyre veçmas ose bashkërisht ose nëse të njëjtat persona do të formojnë Këshillin e Administrimit. Me vendimin për emërimin e Administratorëve, ortakët vendosin në mënyrë të veçantë: numrin e tyre, strukturën e organit administrativ dhe çdo kërkesë për autoritetet administruese, të cilat njëkohësisht i atribuohen kompetencës së vendimit të aksionarëve. Në çdo rast, përgatitja e draftit të pasqyrave financiare dhe projektet e bashkimit

ose shkrirjes, si dhe vendimet për rritjen e kapitalit në përputhje me nenin 2481 i Kodit Civil, janë përgjegjësi e Këshillin e Administrimit, përveç në rast se emërohet një drejtor i vetëm.

NENI 15) KËSHILLIN E ADMINISTRIMIT

Nëse emërohet më shumë se një administrator, ai do të emërojnë mes tyre Kryetarin e Këshillit të Administrimit, nëse vendimi i aksionarëve nuk e ka bërë këtë.

Këshilli mbledhet si në selinë e regjistruar edhe gjetkë, mjafton të jetë në Itali; thirrja e Këshillit mund të bëhet nga secili këshilltar ose, nëse emërohet, auditorët ose auditori me një letër që dërgohet në banesën e secilit këshilltar të paktën pesë ditë para mbledhjes dhe në raste urgjente me telegram, faks ose e-mail që do të dërgohen të paktën dy ditë më parë. Thirrja me faks ose e-mail do të jetë e mundur vetëm me numrin e faksit ose adresën e postës elektronike të treguar nga administratorët e vetëm dhe që rezultojnë në vendimin e ortakëve.

Pjesëmarrja në mbledhjet e këshillit gjithashtu mund të bëhet me anë të telekomunikacionit, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe të lejohen të ndjekin diskutimin, të marrin, transmetojnë ose të dokumentojnë, të ndërhyjnë gojariisht dhe në kohë reale në të gjitha temat.

Vlefshmëria e vendimeve të këshillit kërkon praninë dhe votimin e favorshëm të shumicës së anëtarëve të tij.

Sidoqoftë, mbledhjet e Këshillit të Administrimit, edhe nëse të thirrura si më lart, janë të vlefshme nëse të gjithë anëtarët e të këtij organi janë të pranishëm dhe i asistojnë Kolegji i Ekspertëve Kontabël, aty ku ekziston. Në këtë rast, secili nga administratorëve të përfshirë mund të kundërshtojë diskutimin e çështjeve në rendin e ditës për të cilat konsiderohet se nuk janë informuar sa duhet.

Vendimet e drejtorëve gjithashtu mund të përshtaten me konsultë me shkrim që do t'i dërgohen çdo administratori dhe secilit anëtar të organit të kontrollit (Auditori i vetëm ose Kolegji i Ekspertëve Kontabël), nëse emërohet, me telegram, faks ose postë elektronike brenda afatit të treguar në kërkesë.

Në këtë rast zbatohet, kur është e përshtatshme, neni 12 i statutit.

Pajtueshmëria me metodën kolegjiale gjithmonë nëse kërkohet nga një ose më shumë administratorë, ose nga Auditori i vetëm ose nga një ose më shumë anëtarë të Kolegji i Ekspertëve Kontabël. Brenda kufizimeve të ligjit, këshilli i administratorëve mund të delegojë kompetencat e tij, tërësisht ose pjesërisht, tek një ose më shumë anëtarë të tij.

NENI 16) – KOMPENSIMI I ADMINISTRATORËVE

Administratorëve i takon rimbursimi i shpenzimeve të bëra për arsye pune.

E njëjta gjë mund të njihet, në aktin e emërimit ose me një vendim të mëvonshëm nga ortakët, një tarifë vjetore, e vendosur në një shumë fikse ose si përqindje e fitimeve; me një vendim të ortakëve, atyre gjithashtu mund të caktohet një shpërblim vjetor si një trajtim i përfundimit të



mandatit, mundësisht edhe duke përcaktuar një policë siguracioni që synon garantimin e disbursimit.

NENI 17) PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

Përfaqësimi i përgjithshëm i Shoqërisë, aktive dhe pasive, thelbësore dhe procedurale i jepet:

- administratorit të vetëm;
- Kryetarin e Këshillit të Administrimit, dhe nëse emërohet, Zv. Kryetarit të Këshillit të Administrimit, si edhe administratorëve të deleguar në kufijtë e kompetenca të dhëna atyre, në rast se ortakët vendosin në aktin e emërimit që shoqëria administrohet ekskluzivisht në formë kolegjiale nga një Këshill Administrimi.
- secilit prej administratorëve veç e veç dhe / ose bashkërisht, në përputhje me modelin organizativ të zgjedhur për administrimin e shoqërisë në përputhje me nenet 2257 dhe 2258 k.c. Akti i emërimit mund të përfshijë kufizime në kompetencat e përfaqësimit të administratorëve, për tu publikuar në të njëjtën kohë me vetë emërimin.

NENI 18) ORGANI I KONTROLLIT

Emërimi i organit të KONTROLLIT është i detyrueshëm duke patur kushtet e përmendura në nenin 2477 paragrafi 2 i Kodit Civil. Si organ kontrolli, ortakët, me një vendim për t'u miratuar në bazë të nenit 12, mund të emërojnë një audit të vetëm ose një Ekspert Kontabël ose një Kolegj të Ekspertëve Kontabël.

Eksperti Kontabël, ose Kolegj të Ekspertëve Kontabël, ka detyrat dhe kompetencat e përcaktuara në Nenet 2403 dhe 2403 bis të Kodit Civil dhe gjithashtu ushtron auditimin ligjor të llogarive në bazë të nenit. 2409 bis i Kodit Civil; në lidhje me këtë, si Eksperti Kontabël, ashtu edhe i gjithë Kolegji i Ekspertëve Kontabël, duhet të bëhen plotësisht nga Revizorët Ligjorë të regjistruar në Regjistrin e posaçëm. Kolegjit të Ekspertëve Kontabël dhe Eksperti Kontabël aplikohen dispozitat në lidhje me shoqëritë aksionare (nenet 2397 dhe ss.)

Kolegji i Ekspertëve Kontabël përbëhet nga tre anëtarë efektiv dhe dy anëtarë shtesë. Kryetari i Kolegjit të Ekspertëve Kontabël emërohet nga ortakët, me vendim të emërimit të vetë Kolegjit. Ekspertët (Kolegji i Ekspertëve Kontabël dhe Eksperti Kontabël) qëndrojnë në detyrë për tre vite dhe u përfundon afati në datën e asamblesë të mbledhur për miratim të bilancit në lidhje me vitin e tretë ushqimor në detyrë. Dorëheqja e ekspertëve për shkak të përfundimit të afatit ka efekt nga momenti në të cilin Kolegji është rikrijuar.

Duhet të mbahet procesverbal ëpr mbledhjet dhe verifikimet e Kolegjit, i cili duhet të transkribohet në Librin e Kolegjit të Ekspertëve Kontabël dhe e nënshkruar nga pjesëmarrësit; vendimet e Kolegjit të Ekspertëve Kontabël duhet të merren me shumicë të të pranishmëve. Edhe Eksperti i Vetëm duhet të transkribojë përcaktimet e veta në një Libër të posaçëm. Zbatohen

dispozitat e neneve 2406, 2407, 2408 dhe 2409 të kodit civil. Revizori Ligjor i Llogarive është person fizik ose shoqëri revizioni regjistruar në Regjistrin përkatës.

Nuk mund të emërohet në zyrën e revizorit dhe, nëse emërohet, bie nga detyra ai që është në kushtet e parashikuara nga arti. 2399 K.C.

Emërimi ka kohëzgjatjen e tre viteve financiare, me datën e përfundimit të vendimit të ortakëve që miraton bilancin në lidhje me vitin e tretë ushtrimor të detyrës.

Auditori ligjor i kryen funksionet në pajtim me nenin. 2409-bis i Kodit Civil.

KAPITULLI V BILANCI DHE FITIMET

NENI 19) BILANCI

Viti ushtrimor fillon në 1 (një) Janar dhe mbyllet më 31 (tridhjetë e një) Dhjetor të çdo viti.

Përfundim i vitit të parë financiar është vendosur në 31 Dhjetor 2009.

Në fund të çdo viti financiar, administratorët procedojnë me sigurimin e bilancit të shoqërisë, sipas ligjit, i cili duhet të paraqitet për vendimin e ortakëve brenda njëqind

njëzet ditë pas mbylljes së vitit ushtrimor, me përjashtim të t duhet të depozitohen në zyrën e regjistrit të ndërmarrjes

drejtës për të shtyrë këtë afat deri në 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë nga mbyllja e vitit ushtrimor në rastet dhe në kushtet e përcaktuara me ligj.

Brenda tridhjetë ditësh nga vendimi e ortakëve për miratimin e bilancit, duhet të depozitohen në zyrën e regjistrit të ndërmarrjes një kopje e bilancit të miratuar dhe lista e ortakeve dhe titullarëve të tjerë të të drejtave mbi pjesëmarrjet në shoqëri.

NENI 20) SHPËRNDARJA E FITIMIT

Vendimi i ortakëve që miratojnë bilancin vendos për shpërndarjen e fitimeve, në varësi të shpërndarjes të 5% (pesë përqind) të saj në rezervën ligjore deri në kufirin maksimal të lejuar me ligj.

Fitimet do t'i shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesëmarrjen në shoqëri në zotërim nga secili prej tyre.

KAPITULLI VI PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shoqëria priset në rastet e parashikuara me ligj. Likuidimi i Shoqërisë do të bëhet nga një ose më shumë likuidues.

Administratorët, njëkohësisht me vlerësimin shkakut të prishjes, duhet të mbledhin asamblenë e ortakëve për të vendosur, me shumicën e parashikuar për ndryshimet e aktit të themelimit ose statutit të shoqërisë për:



- a) numrin e likuiduesve dhe rregullat për funksionimin e kolegjit në rast të një shumicë të likuidatorëve;
- b) emërimin e likuiduesve, duke përcaktuar ata që do të përfaqësojnë shoqërinë;
- c) kriteret sipas të cilave duhet të bëhet likuidimi; kompetencat e likuiduesve, në lidhje të veçantë me transferimin e shoqërisë, të degëve të saj, apo edhe të pronave ose të drejta të vetme, ose blloqe të tyre; aktet e nevojshme për ruajtjen e vlerës së shoqërisë, përfshirë këtu ushtrimi i tij i përkohshëm, qofshin edhe degë të veçanta, në funksion të realizimit më të mirë.

Neni 22) REVOKIMI NGA GJENDJA E LIKUIDIMIT

Shoqëria mund të revokojë statusin e likuidimit në çdo kohë, ku është e nevojshme eliminimi me parë i shkakut të prishjes, me vendim të asamblesë të miratuar me shumicat e kërkesave për ndryshimet e këtyre marrëveshjeve të shoqërisë.

Në rast të revokimit të statusit të likuidimit, ortakut që nuk e ka lejuar vendimin i takon e drejta e dorëheqjes me efektet e nenit 10) të këtij statuti. Vendimi që revokon gjendjen e likuidimit hyn në fuqi vetëm dy muaj pas regjistrimit në Regjistrin e Shoqërive, përveç nëse ekziston pëlqimi i kreditorëve të kompanisë ose pagesa e atyre që nuk kanë dhënë pëlqimin.

KAPITULLI VII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 23) Klauzola e pajtimit

Palët bien dakord që të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me këtë kontratë, edhe pse kanë të drejtat, duhet të bëjnë përpjekjeje për zgjidhje përmes pajtimit, bazuar në procedurën e pajtimit të Dhomës së Tregtisë kompetente në lidhje me selinë e shoqërisë, në fuqi në datën kur mosmarrëveshja i drejtohet për pajtim, ose në bazë të procedurës të një organ tjetër pajtimi regjistruar në regjistrin përkatës të mbajtur pranë Ministrisë së Drejtësisë, të përzgjedhur me kërkesë të shprehur dhe në pajtim të palëve.

Çdo mosmarrëveshje e pa zgjidhur përmes pajtimit, brenda 60 ditëve nga fillimi i kësaj procedure ose në një afat tjetër që palët bien dakord me shkrim, do të zgjidhen përfundimisht nga një arbitër, që duhet të zgjidhet, me vendim të palës më të kujdesshme, nga kryetari i gjykatës së vendit ku ka selinë shoqëria.

Arbitri do të formojë përcaktimin e tij sipas ligjit në ritual, duke respektuar në procedurë rregullat e detyrueshme të Kodit të Procedurës Civile Italiane.

Selia e arbitrazhit do të jetë në vendin ku është vendosur shoqëria.

Arbitri do të punojë dhe gjykojë sipas rregullave të përcaktuara me Kodit të Procedurës Civile në fuqi dhe gjithashtu do të parashikojë shpenzimet dhe kompetencat që i takojnë.

Ndryshimet në këtë klauzolë dhe shtypja e saj miratohen me votimin e favorshëm të aksionarëve që përfaqësojnë të paktën dy të tretat e kapitalit aksionar, përveç të drejtës së tërheqjes së aksionarëve që mungojnë ose kundërshtojnë.

NENI 24) ADRESA E ORTAKËVE PËR RAPORTET ME SHOQËRINË

Për qëllimet e këtij statuti, të gjitha komunikimet drejtuar për ortakët e veçantë do të bëhen në adresën e secilit ortak që rezulton nga regjistri i ortakëve.

Libri i ortakëve duhet të tregojë adresën dhe, nëse janë njoftuar, numri i telefonit, numri i faksit dhe adresa e postës elektronike.

Çdo ndryshim i mëvonshëm i informacionit që përbëjnë adresën në përputhje me këtë nen do të bëhet me njoftim me shkrim të administratorët që do ta regjistrojnë atë në regjistrin e ortakëve.

Përgjegjësia për mos komunikimin e ndryshimeve të lartpërmendura mbetet përgjegjësi e secilit ortakë.

Neni 25) SHTYRJE

Për sa nuk është parashikuar shprehimisht në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e kodit civil dhe legjislacioni i posaçëm mbi çështjet.

Firmosur: Cristina Gamba - Mirco Paolini – Noter Marcello Porfiri

Njësi me origjinalin që lëshohet për përdorimet e lejuara nga ligji.

Cessena, 13 shtator 2019

Prefektura e Forli

Apostile

(Konventa e Hagës e datës 5 tetor 1961)

1. vendi Itali

Ky dokument zyrtar

2. është firmosur nga Marcello Porfiri

3. i cili vepron në cilësinë e Noterit në Cesena (FC)

4. dhe mban vulën/pullën e noterit

Vërtetohet

5. në Forli 6. më 25 Shtator 2019

7. nga Znj. Federica Messina Zëvendës Prokuror i Republikës

8. nr. 1008/2019 Regj. i Apostillës

9. vula/pulla

10. firma.....

Prokuror i Republikës

Znj. Federica Messina - Zëvendës

Firma:
Federica Messina



REPUBLIKA E SHQIPERISE
Notere: Valbona SH. SELIMI

Adresa: Rr. Hoxha Tahsim, Godina nr. 292, Tirane
Cel. 069 57 61 243; email: valbona.syri@gmail.com



Nr. 5738 Rep

VERTETIM PERKTHIMI

Sot me date 17/10/2019, para meje noteres Valbona Selimi, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, me zyre noteriale ne Rr. Hoxha Tahsim, Godina nr.292, kati I, Tirane, u paraqit personalisht Znj. Gentiana Koduzi, shtetase shqiptare, e bija e Fadilit, e datelindjes 3.07.1980, lindur ne Lushnje dhe banuese ne Tirane, prane Kopshtit Zoologjik, mbajtese e leternjoftimit nr. 029032702, e cila me deklaroi se perktheu personalisht nga italisht ne shqip dokumentat bashkangjitur ketij vertetimi, ne menyre te plote e te sakte, dhe une noterja vertetoj nenshkrimin e vendosur prej saj ne aktin e perkthyer bashkangjitur sipas ligjit.

Ky vertetim leshohet nga une noterja ne baze te ligjit nr.110/2018 'Per noterine' dhe udhezimit nr.7203 date 16.09.2009, pika 2 te Ministrit te Drejtesise.

VALBONA SELIMI NOTERE